

Përmbajta

Përmbajta	1
Lista e Grafikonëve.....	5
Lista e Tabelave	5
Figurat.....	6
Shkurtesat.....	7
1. Përmbledhje Ekzekutive	9
Objektivat.....	11
2. Korniza ligjore	12
2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në	12
2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	14
2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet.....	14
3. Përshkrimi i ARH-së.....	16
3.1. Misioni/Vizioni	16
3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit.....	16
3.2.1. Departamenti i Rregullimit të Tregut	16
3.2.2. Departamenti i Sigurisë	17
3.2.3. Departamenti i Interoperabilitetit	17
3.2.4. Departamenti i Licencimit.....	17
4. Fushëveprimi institucional.....	18
4.1. Struktura organizative e ARH-së	18
4.2. Pagat e personelit të ARH-së.....	18
4.3. Skema organizative e ARH-së	19
4.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së	20
4.4.1. Mandati.....	20
4.4.2. Kompetencat.....	20

4.4.3. Funksionalizimi	20
4.4.4. Puna e Bordit	21
4.4.5. Numri i mbledhjeve.....	21
4.4.6. Vendimet	21
4.4.7. Arsyetimet për vendimet	21
4.5. Ekzekutivi.....	21
4.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.....	21
4.5.2. Menaxhmenti i mesëm	22
4.5.3. Mandati.....	22
4.6. Burimet njerëzore	22
4.6.1. Numri i punëtorëve.....	22
4.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj.....	22
4.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim	22
4.6.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar	24
4.6.4.1 Traktati i Komunitetit të Transportit- TCT.....	24
4.6.4.2 Agjencioni European i Hekurudhave - ERA.....	26
a. Auditimi/Monitorimi i Autoritetit Nacional të Sigurisë në Poloni	26
b. Seminar: Hyrje në modelin evropian të kulturës së sigurisë hekurudhore	27
c. IRS-Rail webinar Post-COVID: Cili do të jetë normaliteti i ri për transportin hekurudhor	27
d. IRS-Rail webinar: Masat ndihmëse COVID-19 të BE-së për sektorin hekurudhor	28
e. Konferenca UIC: Dita Ndërkombëtare e ndërgjegjësimit për kalimin në nivel rrugë-hekurudhë	28
f. Konferenca: Autorizimi, Certifikimi dhe Miratimi	29
g. IPA SEMINAR: Inovacioni në Hekurudha	29
h. ERA & ENISA Seminar: Siguria Kibernetike në Hekurudha	30
i. 55th NSA Network meeting: Takimi i 55 i Rrjetit të NSA BE	30
4.7. Asetet.....	31

4.7.1. Asetet në posedim të institucionit	31
4.7.2. Planet për asete të reja	31
5. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH	32
5.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit 32	
5.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2020.....	32
5.2.1. Plani i performances së ARH për vitin 2021	34
5.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit.....	35
5.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues.....	35
6. Puna gjatë vitit raportues	36
6.1. Aktivitetet legjislative të ARH-së	36
6.2. Përbushja e obligimeve nga agjenda e integritit Evropian	37
6.3. Përfaqësimet Ligjore	38
6.4. Inspektimet	39
6.4.1. Inspektimi i makinistëve	39
6.4.2. Inspektimi i Infrastrukturës Hekurudhore	39
6.4.3. Inspektimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore	40
6.4.4. Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR	40
6.5. Monitorimet.....	42
6.5.1. Monitorimi i licencave	42
6.5.2. Monitorimi i tregut hekurudhor.....	42
6.6. Ekspozeu i Rrjetit 2020	43
6.7. Aplikime të reja	44
6.7.1. Licenca	44
6.7.2. Njohja e Licencave për Makinist.....	45
6.7.3. Shqyrtimi i aplikacioneve të mjeteve lëvizëse të kompanisë italiane Generale Costruzione Ferroviare - GCF për autorizim dhe regjistrim.....	48
6.8. Azhurnimi i Regjistrave	49

6.8.1. Regjistri i Licencave në kuadër të ARH-së	49
6.8.2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave.....	50
6.8.3. Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR)	50
6.8.4. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së.....	51
6.9. Aktivitetet për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore	53
6.9.1. Raporti Vjetor i Sigurisë.....	53
6.10. Administrata	54
6.11. Financa	55
6.11.1. Pasqyrat financiare	55
6.12. Prokurimi.....	68
6.13. Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike.....	69
7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm	71
8. Shtojcat	72
8.1. Shtojca I - Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës	72
8.2. Shtojca 2. Statistika nga Departamenti i Sigurisë	74
8.3. Shtojca 3. Statistika te Tregut.....	77

Lista e Grafikonëve

Diagrami 1. Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	75
Diagrami 2. Numri i personave të vdekur.....	75
Diagrami 3. Numri i personave të lënduar	76
Diagrami 4. Dëmet materiale	76
Diagrami 5. Transporti i udhëtarëve	77
Diagrami 6. Te dhënat për transportin e mallrave	78

Lista e Tabelave

Tabela 1. Lista e shkurtesave	8
Tabela 2. Trajnimet dhe përfaqësimet kryesore gjatë vitit 2020	23
Tabela 3. Planifikimi i punës 2020 dhe realizimi	34
Tabela 4. Kompanitë hekurudhore.....	41
Tabela 5. Marrëveshjet ndërkufitare dhe vendore hekurudhore të Kosovës.....	53
Tabela 6. Pasqyrat financiare për vitin 2020	56
Tabela 7. Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH-në per vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.....	57
Tabela 8. Realizimi i buxhetit për paga	58
Tabela 9. Pasqyra e shpenzimeve në kategorin mallra dhe shërbime.....	59
Tabela 10. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë Shpenzime Komunale	60
Tabela 11. Pasqyra e të hyrave vetanake	61
Tabela 12. Pasqyra e të hyrave në kategorinë subvencione dhe transfere	62
Tabela 13. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale	63
Tabela 14. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale si dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 2020 (Janar - Dhjetor 2020).	67

Tabela 15. Paraqitja tabelare e kërkesave të pranura për qasje në dokumente publike, në tri vitet e fundit	70
Tabela 16. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit 2019.....	71
Tabela 17. Ngjarjet e jashtëzakonshme	74
Tabela 18. Numri i personave të vdekur dhe lënduar	74
Tabela 19. Numri i udhëtarëve sipas viteve.....	77
Tabela 20. Krahasimet në transportin e udhëtarëve.....	77
Tabela 21. Sasia e transportit të mallrave	77
Tabela 22. Krahasimet në transportin e mallrave	78

Figurat

Figura 1. Skema organizative e ARH-së.....	19
Figura 2. Takimi për masat ndihmëse post-COVID	28
Figura 3. Konferenca UIC.....	29
Figura 4. Takimi mbi sigurinë kibernetike në hekurudha.....	30
Figura 5. Realizimi i aktiviteteve gjatë vitit 2020.....	68
Figura 6. Harta e Hekurudhave në Republikën e Kosovës	73

Shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DG MOVE	Drejtoria Gjenerale për Mobilitet e Transport
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
EC	European Commission (Komisioni Evropian)
ERA	European Union Agency for Railway (Agjensioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave)
ERR	Ekspozeu i Rrjetit
ERTMS	The European Rail Traffic Managemenet System (Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor)
GCF	Generale Costruzioni Ferroviarie S.p.A (Kompania italiane e përzgjedhur për rehabilitimin e linjës së 10-të)
HK	Hekurudhat e Kosovës
INFRAKOS	Menaxheri i Infrastrukturës- "Hekurudhat e Kosovës Infrakos" Sh.A.
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NH	Ndërmarrje hekurudhore
NSA	National Safety Authority
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
OB	Organizatrat Buxhetore

RAILTRANS	Operator privat per transport te mallrave
SMS	Safety Management System (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Technical Specification for Interoperability)
TCT	Traktati i Komunitetit të Transportit
TRAINKOS	Operimi me Trena - "Hekurudhat e Kosovës Trainkos" Sh.A.
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjzimi i Mbajtesit të Mjetit Lëvizës)

Tabela 1. Lista e shkurtesave

1. Përmbledhje Ekzekutive

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH), për periudhën raportuese 01 janar-31 dhjetor 2020 ka përgatitur Raportin Vjetor, i cili nga pasqyron të arriturat institucionale, me qëllim që të ofroj një pasqyrë të zhvillimeve në këtë fushë. Ky raport, përveç pjesës së përgjithshme, përshkruan gjerësisht edhe aktivitetet dhe përgjegjësitë e funksionimit, siç janë: Licencimi, Siguria, Interoperabiliteti, Rregullimi i Tregut, Administratës dhe Financave. Po ashtu, në këtë raport, janë të përfshira edhe sfidat me të cilat është përball ARH, në punën dhe aktivitetet e sajë, gjatë vitit raportues.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës (LH) i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së, është përcaktuar edhe roli dhe funksionimi i ARH-së. Pra, ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ngarkuar me përgjegjësitë për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit hekurudhor në Kosovë. ARH, në punën dhe vendimet e saj, ofron transparencë dhe jo diskriminim, për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Kosovë.

Raporti në tërësi ofron informacion mbi: bazën ligjore, përshkrimin dhe organizimin institucional, përshkrimin e fushës që mbulon ARH, punën gjatë vitit paraprak, sfidat, raportin financiar, raportin rreth rekomandimeve të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe anekset.

Duke qenë se ARH vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut, edhe përmbajtja e raportit elaboron me specifikisht progresin dhe arritjen e objektivave të saj kryesisht në këto fusha. Edhe gjatë vitit 2020, ARH ka vazhduar të ushtrojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi: Është organ përgjegjës për lëshimin e licencave për menaxherin e infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore dhe makinist, si dhe bënë amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre licencave. Ky organ gjatë vitit raportues, ka realizuar një sërë aktivitetesh me përkushtim dhe angazhim maksimal si: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licenca të makinistëve, monitorimi i licencave të lëshuara, përfshirë inspektimet për makinistët e licencuar, hartimi i raporteve të veçanta për aktivitetet e lartcekura, përditësimi i regjistrit të licencave dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin që e rregullon këtë fushë.

Siguria: Organi i sigurisë punën dhe aktivitetin e vet gjatë vitit paraprak kryesisht e ka bazuar në Planin Vjetor të Punës. Fokusi kryesor i punës ka qenë i bazuar në disa shtylla kryesore siç

janë: Kërkesat që dalin nga Ligji i Hekurudhave, përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Associmit (PKZMSA), Zbatimit të Reformave Evropiane (ERA) si dhe Obligimeve të cilat rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Transportit. Gjatë vitit 2020 është përgatitur Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2019. Inspektimi i të gjitha linjave dhe mjeteve lëvizëse në menaxhim të Infracos-it si dhe janë inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse në menaxhim të Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it. Pas procesit të inspektimit ne kemi përgatitur nga një raport me rekomandime për të gjitha të gjeturat gjatë inspektimeve.

Të gjitha këto raporte të përgatitura nga ana jonë janë dërguar te kompanitë përkatëse.

Interoperabiliteti: për të zhvilluar kornizën nacionale të interoperabilitetit hekurudhor, me qëllim të harmonizimit të sistemit hekurudhore në përputhje me rregullat dhe standardet evropiane të obligueshme për Kosovën, ARH ka realizuar aktivitetet si në vazhdim: rregulloren 04/2020 në lidhje me specifikacionet teknike për interoperabilitet për nënsistemin kontroll - komandë dhe sinjalizim STI CCS, obligim që derivonë nga ligji i hekurudhave dhe agjenda e integritetit evropian/ Traktati i Komunitetit të Transportit.

Gjithashtu janë realizuar edhe aktivitete të tjera që realizohen në baza vjetore si: inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR i të gjitha kompanive hekurudhore dhe përgatitja e raporteve me rekomandime ndaras për secilën kompani, përditësimin e regjistrit NVR, përditësimin e marrëveshjeve ndërkombëtare hekurudhore, etj.

Rregullimi i Tregut: Organ përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë. Gjatë vitit raportues ky organ, ka zhvilluar aktivitete siç janë: shqyrtimi i ankesave për tregun hekurudhor, inicimin dhe mbajtjen e procesit të konsultimeve me palët e interesit gjatë procesit të konsultimit për Ekspozeun e Rrjetit 2020, duke siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese. Monitorimi dhe kontrolli i marrëveshjes mbi qasje në binar në mes të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Gjithashtu është bërë edhe monitorimi i tregut hekurudhore si dhe është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut 2019 dhe është dërguar në IRG-Rail. Rregullimi i Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor, veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve dhe IRG – Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera.

Objektivat

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, në vitet e ardhshme presim të kemi rezultate më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH, edhe më tej vazhdon të këtë qëllim kryesor zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të transportit hekurudhor, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e shërbimeve të transportit hekurudhor.

2. Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063;
- Ligji Nr. 06/L-067 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat E Kosovës;
- Rregullore e Brendshme e ARH për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012, për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012, për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012, për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore;
- Rregulloren Nr. 01/2012, për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 03/2012, për Certifikatat e Sigurisë;
- Rregullore Nr. 05/ 2012, për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore. Kjo rregullore transponon Direktiven 2008/57/EC dhe Vendimin 2007/756/EC;
- Rregullore Nr. 06/ 2012, për Regjistrimin e Infrastrukturës;
- Rregulloren Nr. 01/2013, për Ekspozeun e Rrjetit;
- Rregulloren Nr. 02/2013, për Licencimin e Makinistëve;
- Rregullore Nr. 01/2014, për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 201/2011/EU;
- Rregullore Nr. 01/2017, për Taksa dhe Gjobat;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor;
- Rregullore Nr. 03/2017 për Të Drejtat e Udhëtarëve;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore;

- Rregullore Nr. 05/2017, Metodatat e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut;
- Rregullore Nr. 06/2017 për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm të ARH-së;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Operatorëve Hekurudhor me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherit të Infrastrukturës me Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2017;
- Rregullorja nr. 01/2018 për llogaritjen e kostos direkte. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/909 / BE;
- Rregullorja nr. 02/2018 për metodatat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e certifikatave të sigurisë hekurudhore. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 1169/2010 / BE;
- Rregullorja nr. 03/2018 për ndërtimin, përmirësimin, ripërtëritjen, vlerësimin e konformitetit dhe autorizimin për funksionalizimin e mjeteve lëvizëse. Kjo Rregullore transponon pjesërisht direktivat dhe rregulloret e BE si: 2004/49 / EC, 2008/57 / EC, 2009/131 / EC, 2008/110 / EC si dhe Rregullorja nr. 402/2013 / BE;
- Rregullorja nr. 04/2018 për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CST). Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2010/409 / BE;
- Rregullorja Nr. 05/2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë' STI INF. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së nr. 1299/2014;
- Rregullorja nr. 06/2018 për përdorimin e një formati të përbashkët evropian për certifikatat e sigurisë, dokumentet e aplikimit dhe vlefshmërinë e certifikatave të sigurisë. Kjo rregullore transponon rregulloren e BE-së nr. 653/2007 / EC;
- Rregullorja Nr.07 / 2018 për miratimin e një metode të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e arritjes së objektivave të sigurisë. Kjo rregullore transponon Vendimin e BE-së Nr. 2009/460 / BE;
- Rregullorja Nr. 08 / 2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Operimit dhe Menaxhimit të Trafikut' STI OPE. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/995;
- Rregullore Nr. 01/2019 për certifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonave të mallrave;

- Rregullore Nr. 02/2019 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsisteme “mjetet lëvizëse – lokomotivat dhe mjetet lëvizëse për udhëtar” STI LOC&PAS. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 1302/2014;
- Rregullore Nr. 03/2019 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsisteme “mjetet lëvizëse – vagonët për transportin e mallrave” STI WAG. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 321/2013;
- Rregullorja Nr.03/2020 për Licencim; dhe
- Rregullorja Nr.04/2020 për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin “kontroll-komandë dhe sinjalizim” STI CCS. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 2016/919;

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Sikurse vitet e kaluara, po ashtu edhe për vitin 2020, ka qenë kërkesë e vazhdueshme, plotësim/ndryshimi i Ligjit aktual për HK. Dhe, deri në momentin e përpilimit të këtij raporti, nuk ka pasur ndonjë hap konkret nga institucionet qendrore në lidhje me këtë çështje.

Për më tepër, edhe Raporti i Progresit për vitin 2020, kërkon nga institucionet e Kosovës që të bëhet plotësim/ndryshimi i LH, më qëllim transpozimin e legjislacionit të BE-së i cili ka hyrë në fuqi, pas miratimit të LH, me theks të veçantë aplikimin e Pakos së Katërt Hekurudhore.

- Paketa e 4-të hekurudhore është një set prej 6 tekstesh legjislativë të dizajnuara për të kompletuar tregun e vetëm për shërbimet hekurudhore (Zona e Vetme e Hekurudhave Evropiane). Qëllimi kryesor i tij është të rigjallërojë sektorin hekurudhor dhe ta bëjë atë më konkurrues krahasuar me format e tjera të transportit. Ai përfshin dy 'shtylla' të cilat janë negociuar paralelisht: "Shtylla Teknike" dhe "Shtylla e Tregut". Shtylla Teknike, nënkupton aspektet e sigurisë dhe të interoperabilitetit, kurse ajo e tregut ka të bëjë me hapjen apo liberalizimin e tregut hekurudhor, rrjedhimisht nënshtrimin të konkurrencës.

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë ndër vite, për të cilat vlerëson se ndikojnë në zbatimin efektiv të LH. Gjatë zbatimit, kemi hasur në disa paqartësi rreth kompetencave ndër institucionale, me theks të posaçëm mes ARH-së dhe Ministrisë së Infrastrukturës si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor. Këto vështirësi janë evidente që nga hyrja në fuqi e LH, në fillim të vitit 2012.

Vështirësitë ligjore dhe përzierja e kompetencave mes këtyre dy institucioneve nga ana e ARH-së janë elaboruar gjerësisht në raportet vjetore paraprake.

ARH raporton se deri në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë ndryshim të legjislacionit i cili do të ndikonte në qartësimin e kompetencave ndër institucionale, pavarësisht faktit se ARH ka kërkuar një gjë të tillë.

3. Përshkrimi i ARH-së

ARH është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani funksionon sipas LH. ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

3.1. Misioni/Vizioni

Misioni - Misioni i ARH-së është rregullimi dhe mbikëqyrja e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

Vizioni - Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas LH, ARH rregullon dhe mbikëqyrë katër fusha specifike përmes këtyre departamenteve profesionale:

3.2.1. Departamenti i Rregullimit të Tregut

Departamenti i pavarur përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovës, dhe shqyrtimin ankesave për tregun hekurudhor, monitorimin e marrëveshjes për kompensimin e obligimeve të shërbimeve publike, sigurimin se pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese, pastaj siguri që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese. Gjithashtu është përgjegjës për negociatat ndërmjet aplikueseve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelin e pagesës për infrastrukturë, dhënien e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtareve dhe mallrave.

3.2.2. Departamenti i Sigurisë

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH-së për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher i infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Gjithashtu ky departament është përgjegjës për lëshimin, rinovimin, amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e autorizimit dhe certifikatave të sigurisë, autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor, mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

3.2.3. Departamenti i Interoperabilitetit

Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së, është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.

Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

3.2.4. Departamenti i Licencimit

Departamenti i pavarur përgjegjës për lëshimin e licencave për menaxherët e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore dhe makinistët. Gjithashtu, ky Departament bënë mbikëqyrjen, amendamentin, dhe suspendimin e licencave të lëshuara nga sektori hekurudhore në Kosovë. Departamenti i Licencimit bënë azhurnimin e regjistrit të licencave.

4. Fushëveprimi institucional

4.1. Struktura organizative e ARH-së

Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Struktura organizative e ARH-së në bazë të Ligjit të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, përbëhet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës;
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Departamenti Ligjor/Licencim;
- d) Departamenti i Sigurisë;
- e) Departamenti i Interoperabilitetit;
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut;
- g) Departamenti i Administratës;
- h) Departamenti i Financave;
- i) Divizioni i Prokurimit

Në bazë të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, skematikisht është paraqitur struktura organizative e ARH-së. Në të njëjten kohë, gjatë vitit 2020, është punuar për plotësim/ndryshim të strukturës së brendshme të ARH-së, me qëllim që punët dhe aktivitetet e ARH-së, të përmbushen në mënyrë me efikase dhe efektive.

4.2. Pagat e personelit të ARH-së

ARH-ja siguron që operimet hekurudhore në Republikën e Kosovës të realizohen në përputhje me Ligjin e Hekurudhave dhe standardet e BE-së. Për ta arritur këtë, rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t'i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve. Përkundër kësaj, niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Si rezultat, ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohë kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.

4.3. Skema organizative e ARH-së




Figura 1. Skema organizative e ARH-së

4.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet Kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Takimet e Bordit drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk ka kuorum. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

4.4.1. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohet më së shumti edhe për një (1) mandat. Mandati i Bordit aktual, ka filluar me datë 28.10.2016 dhe i njëjti përfundon me datë 27.10.2021.

4.4.2. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore, sic janë: licencimi, siguria, interoperabiliteti si dhe rregullimi tregut dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të saj.

4.4.3. Funksionalizimi

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së është funksional në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

4.4.4. Puna e Bordit

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së, punën dhe përgjegjësinë e vet e kryen bazuar në kompetencat ligjore që ka. Puna e Bordit është e fokusuar në mbikëqyrjen e realizimit të punëve dhe detyrave të institucionit si dhe në vendimmarrjen në proceset që janë në kompetencë të Bordit.

Duhet theksuar se puna në mbikëqyrje, vendimmarrje dhe përfaqësim, është bërë në koordinim të plotë mes anëtarëve të Bordit por edhe në konsultim të vazhdueshëm me Drejtorin e Përgjithshëm, rrjedhimisht me menaxhmentin.

4.4.5. Numri i mbledhjeve

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, Bordi Mbikëqyrës, duhet të mbajë të paktën një mbledhje në çdo muaj, dhe sipas nevojës mund të zhvilloj edhe mbledhje tjera, varësisht nga nevojat dhe kërkesat.

Brenda vitit 2020, ARH ka mbajtur 12 takime të rregullta.

4.4.6. Vendimet

Vendimet e Bordit të ARH-së, të cilat vlen të theksohen janë:

- Vendimet për miratimin e rregulloreve, të cilat janë cekur më lartë
- Vendimet për miratim të Raportit Vjetor 2019
- Vendimet për miratim të raporteve të sigurisë, tregut, etj.

4.4.7. Arsyetimet për vendimet

Të gjitha vendimet e Bordit, janë marrë brenda kornizës ligjore dhe mandatit që Bordi i ARH-së ka në bazë të LH si dhe rregullores për funksionimin e brendshëm të ARH-së.

4.5. Ekzekutivi

4.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

4.5.2. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve dhe stafi profesional, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara me detyrat e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas Rregullores së Brendshme dhe mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukture apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme.

4.5.3. Mandati

Drejtori i Përgjithshëm, është me kontratë punësimi me kohë të caktuar.

Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.6. Burimet njerëzore

4.6.1. Numri i punëtorëve

ARH-ja ka 23 punëtorë shërbyes civil, pa përfshirë katër (4) anëtarët e Bordit të cilët nuk janë shërbyes civil.

4.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj

ARH ka nevojë për punëtorë të rinj shtesë, në mënyrë që të përmbush mandatin e vet ligjor. Sidomos pas fillimit të punimeve në rehabilitim të linjave hekurudhore edhe investimet që kanë filluar në sektorin e hekurudhave e që pritet të rrisin volumnin e punëve edhe për ARH-ën në aktivitetet mbikëqyrëse dhe inspektuese.

4.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim

Zyrtarët e ARH –së gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë me Covid-19 kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme, kryesisht organizuar nga ERA në vende të BE-së si dhe vende të regjionit. Po ashtu, zyrtarët e ARH-së gjatë vitit raportues kanë ndjekur trajnime brenda vendit, të organizuara nga institucionet kompetente siç janë: Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Financave (MF),

Ministria e Integriteteve (MIE), etj. Trajnimet dhe pjesëmarrja janë organizuar Online përmes platformave online .

ARH, krahas zhvillimeve të reja, në vazhdimësi ka nevojë për ngritje të kapaciteteve profesionale duke ndjekur trajnimet e nevojshme në fushën e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit, rregullimit të tregut si dhe në fushat tjera mbështetëse, si: administratë, financa, resurse humane dhe prokurim.

Trajnimet, dhe punëtoritë kryesore janë paraqitur në formë tabelare si në vijim:

Tabela 2. Trajnimet dhe përfaqësimet kryesore gjatë vitit 2020

Nr.	Trajnimi	Organizatori/Implementuesi
1	Planifikimi dhe vendimmarrja'	IKAP
2	Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore	IKAP
3	E drejta për informim dhe Administrata Publike	IKAP
4	Menaxhimi i Programeve Punë-Jetë në Shërbimin Publik	IKAP
5	Modulin Pamje dhe Raportim	Thesari
6	Modulin e Planit të Kesh-it	Thesari
7	Ngritja e performancës së organizatave buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve nga RVA 2019	Thesari
8	Mirësjellja dhe Protokolli	Akademia Diplomatike
9	Komunikimi Strategjik	Akademia Diplomatike
10	Introduction to the European Railway Safety Culture Model	Agjencia Evropiane e Hekurudhave – ERA

11	Post-COVID: Ëhat ëill be the new normal for rail travel	IRS RAIL WEBINARS
12	“On-Demand: EU’s COVID-19 relief measures for the rail sector”	IRS RAIL WEBINARS
13	International Level Crossing Awareness Day	UIC
14	Certification, Authorisation and Approval	ERA
15	Game changer for a carbon neutral economy - railëay contribution to the Green Deal	ERA
16	Innovation in railëays	ERA
17	Cybersecurity in Railëays	ERA
18	55th NSA Netëork meeting“- Microsoft Teams	ERA
19	The 8th ERA- Hungary ëorkshop “The development of rail safety and interoperability in the mirror of the 4th Railëay Package: 26th November 2020 from 08:40h to 17:00h (CET)”	ERA
20	Human and Organisational Factors (HOF) in Railëay Automation	ERA

4.6.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar

ARH ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare për transportin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe ka ofruar përkrahje profesionale në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

4.6.4.1 Traktati i Komunitetit të Transportit- TCT

Kosova, që nga viti 2018 kur edhe është miratuar Ligji për Ratifikimin e Traktatit që Themelon Komunitetin e Transportit Nr. 06/L-109, ka hyrë ne obligime që rrjedhin nga ky traktat.

Një sistem hekurudhor i sigurt, gjithëpërfshirës, i besueshëm, i qëndrueshëm mjedisor dhe shoqëror dhe i ndërlidhur brenda rajonit dhe me BE-në, është qëllimi kryesor i Komunitetit të

Transportit. ARH, përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të hekurudhave është njëra nga institucionet që duhet të përmbush pjesën dërmuese nga këto obligime në fushën e hekurudhave, kryesisht në hartimin e legjislacionit sekondar për hekurudhat e Kosovës. ARH mbetet e përkushtuar maksimalisht ndaj përgjegjësive të traktatit, duke e dëshmuar këtë edhe me përgatitjen dhe miratimin e shumë akteve legjislative që derivojnë nga ky traktat. Komuniteti i Transportit mbështetet nga Sekretariati i Përhershëm, me seli në Beograd.

Komiteti Teknik për Hekurudhat, i krijuar nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit, si një organ përkatës për të gjitha çështjet hekurudhore, bazuar në të dhënat e mbledhura për legjislacionin hekurudhor në rajon, përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ka përgatitur Planin Hekurudhor të Veprimit që mbulon periudhën 2020-2023. Ky plan veprimi jep një pasqyrë të plotë të nivelit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar hekurudhor me acquis të BE-së.

ARH vazhdimisht ka kontribuar në ofrimin dhe sigurimin e këtyre të dhënave të paraqitura në planin hekurudhor të veprimit, kurdoherë që është kërkuar, qoftë përmes kërkesave zyrtare ose përmes takimeve që janë organizuar nga sekretariati.

Plani i veprimit hekurudhor për zhvillimin e një strategjie hekurudhore rajonale në Ballkanin Perëndimor është i ndarë në gjashtë lloje të veprimeve:

- Hapja e tregut hekurudhor,
- Të drejtat e pasagjerëve,
- Operacionet e përbashkëta në kalimet kufitare,
- Interoperabiliteti, dhe
- Modernizimi i infrastrukturës hekurudhore.

ARH më 06.11.2020 ishte pjesëmarrëse në takimin e rregullt të organizuara nga Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Transportit. Në këtë takim, bashkërisht kemi identifikuar sfidat dhe prioritetet që ne si ARH kemi para vetes në avancim dhe zhvillim të sektorit hekurudhor, ku jemi dakorduar që të kërkojmë edhe asistencë teknike nga BE për adresim të suksesshëm të sfidave që aktualisht kemi, si p.sh. mungesa e kodit hekurudhor shtetëror, regjistri elektronik i mjeteve lëvizëse, etj.

4.6.4.2 Agjencioni European i Hekurudhave - ERA

Bashkëpunimi ARH – ERA gjatë vitit 2020, edhe përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia ka vazhduar, duke u përshtatur me rrethanat e reja. ARH me ftesë të ERA-së, ka qenë pjesëmarrëse në të gjitha takimet, punëtoritë, konferencat që janë organizuar nga Agjencioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave për vendet përfituese të IPA-së gjatë vitit 2020. Si rezultat i pandemisë COVID-19, takimet janë mbajtur të gjitha nga distanca /online.

a. Auditimi/Monitorimi i Autoritetit Nacional të Sigurisë në Poloni

ERA monitoron performancën dhe vendimmarrjen e Autoriteteve Nacionale të Sigurisë përmes auditimit dhe inspektimeve, në emër të Komisionit Evropian, siç është mandatuar nga Rregullorja (BE) 2016/796. Kjo rregullore i jep të drejtë ERA-së, të kontrollojë aftësinë e NSA-ve për të ekzekutuar detyra në lidhje me sigurinë hekurudhore si dhe efektivitetin e monitorimit nga Autoritetet Nacionale të Sigurisë, siç referohet në Direktivën e re për Siguri (BE) 2016/798.

ERA në bashkëpunim me Komitetin Teknik për Hekurudha nga Komuniteti i Transportit për herë të parë kanë përzgjedhur që për vitin 2020 nga vendet përfituese të IPA-së të delegohet përfaqësuesja nga ARH/Kosovë si vëzhgues (observer) në auditimin dhe monitorimin e Autoritetit Nacional të Sigurisë në Poloni-UTK. Paraprakisht për këtë pjesëmarrje, është bërë ftesë nga ERA dhe Komiteti Teknik për Hekurudha, drejtuar MI-së dhe ARH-së. Kanë qenë 2 (dy) aplikues nga MI dhe 1(një) nga ARH-ja. ERA, në bazë të kriterëve të vlerësimit, ka përzgjedhur zyrtaren nga ARH-ja.

Fusha e auditimit dhe monitorimit sipas vendimit Nr. 188 të Bordit Menaxhues të Agjencionit të Bashkimit Evropian për Hekurudha ERA, ka qenë e kufizuar në dy çështje:

- Menaxhimi i kompetencave brenda NSA, me një fokus specifik në kompetencat për mbikëqyrje, certifikimin e sigurisë dhe autorizimin e mjeteve lëvizëse .
- Aktivitetet e mbikëqyrjes së NSA.

Pjesë e auditimit ka qenë edhe implementimi i Paketës së 4 Hekurudhore, aktivitetet mbikëqyrëse dhe impakti i saj.

Gjatë fazës të auditimit, grupi i auditorëve të ERA-së përfshirë edhe vëzhguesin nga ARH kanë kërkuar prova, raste studimore, kanë organizuar takime të rregullta me zyrtarë nga

UTK-Poloni, takime të rregullta ditore me anëtarët në fund të çdo auditimi, për t'i prezantuar gjetjet ditore gjatë auditimit.

Për shkak të situatës aktuale më pandeminë Covid-19, aktivitetet në terren të planifikuara fizikisht në Varshavë dhe Skierniewice / Łódź, janë organizuar në distancë. Një takim përmbyllës është mbajtur në fund të fazës së auditimit, duke përfshirë edhe kreun e UTK Poloni. Qëllimi i takimit përmbyllës ishte prezantimi i gjetjeve kryesore të auditimit.

b. Seminar: Hyrje në modelin evropian të kulturës së sigurisë hekurudhore

Me datën: 19/05/2020, është mbajtur seminari “Hyrje në modelin evropian të kulturës së sigurisë hekurudhore”, në të cilin ishte e ftuar edhe ARH. Çfarë është kultura organizative dhe çfarë do të thotë kultura pozitive e sigurisë, ishin temat e prezantuara dhe të diskutuara nga distanca në këtë seminar online, i organizuar nga Agjensioni i Bashkimit Evropian për Hekurudha - ERA.

Përmes diskutimeve interaktive është shpjeguar kultura e sigurisë nën kornizën e modelit evropian hekurudhor, për të mbështetur të gjitha grupet e interesit në kontributin e tyre për përmirësimin e sigurisë hekurudhore.

c. IRS-Rail webinar Post-COVID: Cili do të jetë normaliteti i ri për transportin hekurudhor

ARH, më datën 02.06.2020 ishte pjesëmarrëse në seminarin e organizuar nga Samiti Internacional i Hekurudhave - IRS “Cili do të jetë normaliteti i ri për transportin hekurudhor”.

Seminari i realizuar në platformën online ishte organizuar me idenë për të mbështetur sektorin hekurudhor rreth shqetësimeve të ngritur pas pandemisë COVID-19. Temat e prezantuara dhe diskutuara ishin: funksionimi i transportit hekurudhor gjatë periudhës me COVID-19, si dhe rregullat e reja të transportit hekurudhor pas pandemisë COVID-19. Seminari ishte i përqendruar në gjendjen e sektorit mes krizës aktuale dhe parashikimeve se si do të duket transporti hekurudhor në një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Ndër të tjera, Drejtor i përgjithshëm i UIC-it (Unioni Ndërkombëtar për Hekurudha) në këtë seminar ka prezantuar Task-Forcën e UIC-it, për rehabilitimin e transportit hekurudhor pas periudhës COVID-19.

d. IRS-Rail webinar: Masat ndihmëse COVID-19 të BE-së për sektorin hekurudhor

Me datën: 09.06.2020, është organizuar seminari i radhës nga Samiti Internacional i Hekurudhave (IRS) "Masat ndihmëse COVID-19 të BE-së për sektorin hekurudhor". Me ftesë të ERA-së, ARH ishte pjesëmarrëse edhe në këtë seminar, i cili është realizuar në distancë.

Humbjet financiare për shkak të COVID-19 dhe çfarë mund të bëjë BE në këtë kohë të vështirë për të mbështetur këtë sektor, ishin tema të diskutuara në këtë seminar. Operatorët hekurudhorë, menaxherët dhe furnizuesit e infrastrukturës kanë kërkuar qartësi, siguri dhe mbështetje urgjente, si për çështjet rregullore ashtu edhe për agjendën legjislative afatgjatë për të luftuar krizën financiare.

Fushata e shqyrtimit urgjent përfshijnë zgjatjen e afatit të zbatimit të Pakos së 4-të të Hekurudhave të 16 Qershorit, dhe uljen e tarifave dhe zgjatjen e vlefshmërisë së licencave dhe certifikatave.




Figura 2. Takimi për masat ndihmëse post-COVID

e. Konferenca UIC: Dita Ndërkombëtare e ndërgjegjësimit për kalimin në nivel rrugë-hekurudhë

Konferenca nga UIC "Dita ndërkombëtare e ndërgjegjësimit për kalimin në nivel rrugë-hekurudhë", është mbajtur me datën: 11.06.2020, si një fushatë ndërgjegjësimi për sigurinë në kalimin në nivel, në kryqëzimin e rrugës me hekurudhë. Fushata u drejtua nga UIC, që nga 25 qershor 2009, në 28 shtete me idenë e mbështetjes dhe që të ngre vetëdijen e publikut mbi

rrëzimet e sjelljes së pa kujdeshme në vendkalimet në nivel. Afërsisht ishin 130 pjesëmarrës, nga 40 vende nga e gjithë bota.




Figura 3. Konferenca UIC

f. Konferenca: Autorizimi, Certifikimi dhe Miratimi

Me datën: 16.06.2020, nga ERA është organizuar konferenca e radhës: “Autorizimi, Certifikimi dhe Miratimi”, në të cilën zyrtarë nga ARH ishin pjesëmarrës.

Në këtë konferencë, u diskutua për procedurat e parapara në Paketën e 4-të për autorizimin për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, certifikimin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe miratim e ERTMS-së përgjatë linjës. Të cilat tashmë kanë kaluar si kompetenca tek ERA, nga NSA-të nacionale. Gjatë konferencës janë prezantuar veprimet e ndërmarra nga ERA për implementimin e kësaj pakoje, përfshirë edhe numrin e autorizimeve dhe certifikatave të lëshuara dhe numrin e miratimeve për ERTMS. Ndër të tjera është diskutuar edhe impakti i pandemisë COVID-19 në aktivitetet e ERA.

g. IPA SEMINAR: Inovacioni në Hekurudha

ARH ka marrë pjesë edhe në seminarin "Inovacioni në hekurudha", organizuar nga IPA/ERA më datën: 04.09.2020. Fokusi i këtij seminari ishte në inovacionet në sistemin hekurudhorë të BE-së, e konkretizuar në funksionimin automatik të trenit. Sinjalizimet e linjës me ERTMS-et dhe përballja me sfidat përcjellëse, ishin disa nga temat që janë diskutuar nga ekspertë të fushës gjatë këtij seminari i realizuar në platformën online.

h. ERA & ENISA Seminar: Siguria Kibernetike në Hekurudha

Me datën 13.11.2020, ERA se bashku me Agjensionin e Bashkimit Evropian për Kibernetikë - ENISA kanë organizuar seminarin online “Siguria Kibernetike në Hekurudha”, në të cilën ishte pjesëmarrëse edhe ARH.




Figura 4. Takimi mbi sigurinë kibernetike në hekurudha

Temë e diskutuar gjerësisht gjatë seminarit ishte përpjekja për transformimin digjital të hekurudhave, në pritje për të sjell mundësi të reja së bashku me sfida të reja.

Ekspertë të fushës kanë prezantuar monitorimet e ERA-së të aktiviteteve hekurudhore në lidhje me kibernetikën në kontekstin hekurudhorë. Tema të diskutuara kanë qenë dhe identifikimi i adoptimit të sistemeve inovative me siguri të lartë të radio-komunikimeve dhe sinjalizimeve, si dhe adoptimet e nevojshme të rregulloreve hekurudhore të BE-së në lidhje me kibernetikën.

i. 55th NSA Network meeting: Takimi i 55 i Rrjetit të NSA BE

Përfituesit e Projektit IPA janë ftuar të marrin pjesë si vëzhgues (observer), më datën: 17-18.11.2020, në Takimin 55-të të Rrjetit të Autoriteteve Nacionale për Siguri Hekurudhore (NSA) të shteteve anëtare të BE. ARH ka marrë pjesë me dy ekspert në cilësi të vëzhguesve ndërsa mbledhja/takimi është organizuar online.

4.7. Asetet

4.7.1. Asetet në posedim të institucionit

ARH-ja ka në përdorim 388 asete më vlerë fillestare në blerje prej 128,240.69 euro. Këto asetet janë kryesisht orendi zyresh dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi i aseteve bëhet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe sipas udhëzimit nr 01/2012 për menaxhimin e pasurisë.

Zhvlerësimi i aseteve në ARH është kryer për asetet mbi 1,000.00 € dhe nën 1,000.00 € Sipas raporteve vlera e aseteve me vlerë mbi 1,000.00 € është 819.70 € ndërsa vlera e aseteve me vlerë nën 1,000.00 € për vitin 2020 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur është 13,275.83 €

4.7.2. Planet për asete të reja

Ka qenë dhe vazhdon të jetë kërkesë e ARH-së sigurimi i zyrave të sajë brenda përbrenda një institucioni publik, me qëllim të evitimit të pagesës së qirasë. Pavarësisht disa kërkesave të ARH-së drejtuar MAP-it, akoma kjo çështje nuk është zgjidhur dhe vazhdon të jetë ngarkesë buxhetore për institucionin.

Zyrat e ARH-së janë në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci” nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 400 m².

Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të tjera, me inventar për zyre dhe mjete tjera për nevoja të ARH-së.

5. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH

5.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH, me punën dhe vendimet e saj, ofron transparencë dhe jo diskriminim për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të LH për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Ndërsa, nga aspekti i angazhimeve në pasurimin e infrastrukturës ligjore, ARH ka miratuar disa rregullore të nevojshme, të cilat i kemi listuar te pika 2.2. e këtij raporti.

5.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2020

Plani i Punës shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Plani i punës hartohet në atë formë duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e obligimeve ligjore, të cilat hartohen në nivel të menaxhmentit. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin dhe përgjegjësitë e ARH-së të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës.

Realizimi i Planit të Punës për vitin 2020

Aktivitetet e planifikuara						Përfunduar	
		Periudha					Në Proces
		K	K	K	K	Statusi	Pa Përfunduar
		I	II	III	IV		
1	Nxjerrja e të gjitha akteve nënligjore të planifikuara në bazë të agjendës të paraparë në PKZMSA, agjendës së reformave evropiane dhe ligjit të hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së.	x	x	x	x	E realizuar	
2	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	x				E realizuar	
3	Përditësimi i regjistrit NVR				x	E realizuar	
4	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar	
5	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar	
6	Rregullat Nacionale të Sigurisë	x	x	x	x	Ne proces (ERA ka marrë përsipër që në bashkëpunim me vendet e IPA-s të përgatisë Rregullat Nacionale të Sigurisë, por që edhe për shkak të pandemisë, akoma nuk është finalizuar ky proces)	
7	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2019	x	x	x	x	E realizuar	
8	Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për të drejtat e udhëtareve			x	x	E realizuar	
9	Monitorimi i marrëveshjes për kompensimin e “Obligimeve të Shërbimeve Publike”	x	x	x	x	E realizuar	
10	Monitorimi dhe kontrollimi i “Marrëveshjes mbi qasjen” në mes të Menaxherit të infrastrukturës dhe operatorëve hekurudhor.	x	x	x	x	E realizuar	
11	Bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me rregullator vendor dhe ndërkombëtar e në veçanti me IRG-Rail të Evropës	x	x	x	x	E realizuar	
12	Përgatitja e Barazimeve vjetore si dhe Përgatitja dhe dorëzimi i Qarkores Buxhetore	X	x	x	x	E realizuar	
13	Realizimi i Planifikimit të Prokurimit sipas nevojave të ARH-së	X	x	x	x	E realizuar	
14	Azhurnimi i Regjistrit të Makinistëve të Licencuar	X	x	x	x	E realizuar	
15	Mbikëqyrja e performancës së sigurisë për MI dhe NH	X	x	x	x	E realizuar	

16	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të tregut Hekurudhor	X	x	x	x	E realizuar
17	Sigurimin se pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës janë transparente dhe jo diskriminuese	X	x	x	x	E realizuar
18	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë			x		E realizuar
19	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, si dhe raportimi në ZKM sipas periudhave të parapara ligjore.	X	x	x	x	E realizuar
20	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës		x	x	x	E realizuar
21	Inspektimi i mjeteve lëvizëse në menaxhim të Infrakos, Trainkos, Rail Trans dhe Feronikel		x	x	x	E realizuar
22	Inspektimi i regjistrat të mjeteve lëvizëse				x	E realizuar

Tabela 3. Planifikimi i punës 2020 dhe realizimi

5.2.1. Plani i performances së ARH për vitin 2021

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave bazuar në obligimet ligjore të dala nga Ligji Nr.06/-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavaruara, neni 43 pika 3 ka përgatitur dhe dorëzuar në afatet ligjore planin e performancës për vitin 2021 në Kuvendin e Kosovës, do të thotë që me kohë ka hartuar dhe propozuar komisionit përgjegjës për infrastrukturë planin e performancës për vitin 2021.

Ky plan është hartuar në përputhje të plotë me Rregulloren (QRK) Nr.03/2020 për Performancën e Agjencive dhe formatin e planit të performancës të ofruar si shtojcë për hartim të këtij dokumenti në rregullore lartcekur.

Vlen të përmendet se Plani i performances i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, paraqet një pasqyrë të objektivave dhe aktiviteteve që janë paraparë që të zhvillohen përgjatë vitit 2021, gjithnjë duke synuar performancë sa më efikase në ofrim të shërbimeve dhe realizim konkret të planit. Planifikimi i objektivave është bazuar në planin strategjik të ARH, Ligjin e Hekurudhave dhe Traktatin e Komunitetit të Transportit.

5.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit

- Miratimi i rregulloreve të reja dhe plotësim/ndryshimi i atyre ekzistuese
- Monitorimi dhe rregullimi i tregut hekurudhor, përfshirë mbikëqyrjen e konkurrencës në transportin hekurudhor;
- Avancimi në aspektet e sigurisë hekurudhore, përmes inspektimeve dhe dhënies së rekomandimeve;
- Shqyrtimi i aplikacioneve të reja për Licencim të makinistëve, si dhe monitorimi i atyre ekzistuese;

5.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues

- Mungesa e Kodit Hekurudhor shtetëror;
- Implementimi i Paketës së 4 hekurudhore;
- Përgatitja dhe implementimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet;
- Mbikëqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve;
- Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore nga ana e ARH-së dhe MIT-së, në harmoni me legjislacionin e BE-së;
- Plotësim/ndryshimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës dhe adaptimi me nevojat dhe kërkesat praktike;
- Përgatitja e Rregullave Nacionale të Sigurisë.

6. Puna gjatë vitit raportues

Aktivitetet dhe të arriturat gjatë vitit raportues 2020, janë të përshkruara më poshtë, të përmbledhura sipas funksionalitetit brenda fushë-veprimtarisë së ARH-së. Dhe atë: në aktivitetet legjislativë, aktivitetet për përmbushjen e obligimeve nga agjenda e integritetit evropian, përfaqësimet ligjore, inspektimet, monitorimet, Ekspozeu i Rrjetit, aplikimet, azhurnimi i regjistrave, aktivitetet për rritjen e sigurisë hekurudhore, punët administrative, aktivitetet që lidhen me fushën e financave, ato të prokurimit, etj.

Për secilën nga këto, është dhënë nga një përmbledhje e aktivitetëve kryesore e të cilat vlerësohet se janë në interes të pasqyrit të saktë të punës së ARH-së, si agjencion i pavarur, por edhe si institucion hekurudhor, me përgjegjësi dhe obligime të caktuara ligjore.

6.1. Aktivitetet legjislativë të ARH-së

LH, i ka dhënë kompetencë ARH-së që të përgatis dhe miratoj legjislacionin sekondar, me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit hekurudhore brenda Republikës së Kosovës, në ato fusha ku ARH ka mandat, siç janë: licencim, siguri, rregullim i tregut dhe interoperabilitet. Ngjashëm sikurse në të kaluarën edhe gjatë vitit 2020, ARH kishte planifikuar hartimin dhe miratimin e disa rregulloreve, të cilat përveçse të nevojshme për sektorin hekurudhor, derivojnë edhe nga Traktati i Komunitetit të Transportit, MSA-ja dhe PKZMSA-ja, në kuadër të agjendës Evropiane të Kosovës. Miratimi i këtyre akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara ka impakt pozitiv në rrugëtimin e Kosovës drejtë agjendës Evropiane, vlerësim ky që BE bënë çdo vit për institucionet e Kosovës në përmbushjes ose jo të obligimeve të tyre.

Në vazhdimësi, ARH-ja, në grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore, përveç stafit të brendshëm në secilin grup punues ka ftuar dhe përfshirë edhe palët e interesit, si Ministria e Infrastrukturës, Menaxherin e Infrastrukturës-Infrakos, Ndërmarrjet Hekurudhore Trainkos dhe Railtrans. Po ashtu, të gjitha draft rregulloret janë dërguar për konsultim publik tek palët e interesit edhe pse të njëjtat kanë qenë pjesë e grupeve punuese. Mbi bazën e komenteve dhe rekomandimeve, ARH-ja ka përgatitur draftin final dhe të njëjtat janë aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së.

Gjatë vitit 2020 ARH ka miratuar rregulloret e mëposhtme:

- **Rregullore Nr.03/2020 për Licencim**, kjo rregullore ka transpozuar Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/171 e datës 4 Shkurt 2015 mbi aspekte të caktuara të procedurës së licencimit të sipërmarrjeve hekurudhore, OJ BE L 29, 5.2.2015. Miratimi i kësaj rregullore ishte e planifikuar në PKZMSA për K2 – 2020, dhe është miratuar nga bordi i ARH-së me datë:30.06.2020, pra brenda afateve të përcaktuara; dhe
- **Rregullorja Nr. 04/2020** për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin kontrolle-komandë dhe sinjalizim. Kjo rregullore ka transpozuar Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/919 e datës 27 maj 2016 mbi specifikacionet teknike për interoperabilitet në lidhje me nënsistemet kontrolle –komande dhe sinjalizim, të sistemit hekurudhore në Bashkimin Evropian. Kjo rregullore është miratuar nga bordi i ARH-së me datë:29.12.2020.

Po ashtu gjatë vitit 2020, ARH ka bërë plotësim ndryshimin e dy rregulloreve me qëllim të harmonizimit të tyre të plotë me LH si dhe avancimit të rregulltivës nënligjore në sektorin hekurudhor. Rregulloret e plotësuara dhe ndryshuara janë si në vijim:

- Rregullore **Nr.01/2020** për ndryshim plotësimin e rregullores Nr.02/2013 për Licencim të Makinistëve, e miratuar nga bordi i ARH-se 27.02.2020; dhe
- Rregullore **Nr.02/2020** për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2017 për Taksa dhe Gjoha, e miratuar nga bordi i ARH-se 27.02.2020.

6.2. Përmbushja e obligimeve nga agjenda e integritit Evropian

Ngjashëm sikurse të gjitha institucione tjera në Republikën e Kosovës, edhe ARH ka rrolin e sajë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda Evropiane, e që kanë të bëjnë me sektorin hekurudhor. Ndaras obligimeve ligjore që derivojnë nga LH, i cili shprehimisht i obligon institucionet e Republikës së Kosovës, që të marrin për bazë legjislacionin Evropian në fushën e hekurudhave, ndër vite ka qenë dhe akoma vazhdon të jetë kërkesë e vazhdueshme edhe e BE-së, e shprehur në raportet e progresit, që Kosova gradualisht të adoptoj dhe harmonizoj të ashtuquajturën Pako e Katërt Hekurudhore, që mes tjerash ka të bëjë me rregullat teknike për siguri dhe interoperabilitet. Një kërkesë e tillë është sforcuar edhe me nënshkrimin e Traktatit të Komunitetit të Transportit, i nënshkruar mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për vitin 2020, ARH ka pas të planifikuara hartimin dhe miratimin e dy rregulloreve të cilat drejtpërsëdrejti transponojnë direktivat e BE-së në fushën hekurudhore të licencimit dhe interoperabilitetit. Dy këto rregullore të lartcekura janë hartuar dhe miratuar nga ARH brenda afateve të përcaktuara në PKZMSA.

Po ashtu, ARH ka qenë gjatë gjithë kohës në kontakt me akterët relevant në planifikimin, përgatitjen dhe raportimin e përmbushjes së obligimeve të veta legjislative për vitin 2020, si Ministria e Integritimeve Evropiane dhe ajo e Infrastrukturës. Ne në vazhdimësi kemi përditësuar edhe inputet për të gjitha zhvillimet në sektorin hekurudhor, për secilin kuartal veç e veç për vitin 2020, të cilat përmes Ministrisë së Integritimeve Evropiane, janë raportuar edhe në Komisionin Evropian.

Gjatë vitit 2020, ne si ARH kemi pasur bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Sekretariatit Permanent të Komunitetit të Transportit, me theks të veçantë rreth Planit të Veprimit në sektorin hekurudhor. Bashkërisht kemi identifikuar sfidat dhe prioritetet që ne si ARH kemi para vetes në avancim dhe zhvillim të sektorit hekurudhor, ku jemi dakorduar që të kërkojmë edhe asistencë teknike nga BE për adresim të suksesshëm të sfidave që aktualisht kemi, si p.sh. mungesa e kodit hekurudhor shtetëror, regjistri elektronik i mjeteve lëvizëse..

6.3. Përfaqësimet Ligjore

Gjatë vitit 2020, përfaqësuesit ligjorë të ARH-së kanë marrë pjesë në dy konteste të ndara gjyqësore, njëri kontest administrativ me kompaninë publike Trainkos dhe tjetri me kompaninë private Railtrans, kontest për kompensim dëmi. Rasti i parë në konflikt administrativ i zhvilluar në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrativë është fituar nga ARH, sepse gjykata ka pranuar argumentet tona ligjore, se padia e paditëses ka qenë e pabazuar. Ndërsa në rastin e dytë procedurat gjyqësore janë duke u zhvilluar ende, ku ARH ka paraqitur argumente të fuqishme se edhe kjo padi është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të hidhet poshtë nga ana e Gjykatës.

6.4. Inspektimet

6.4.1. Inspektimi i makinistëve

Në respektim të kërkesave ligjore për një rrjet hekurudhor të sigurt dhe të mbikëqyrur, ARH sipas vlerësimeve të brendshme bënë edhe inspektimin e makinistëve (drejtueseve të trenave) nëse trenat janë duke u drejtuar nga makinistë të cilët janë të licencuar. Edhe gjatë vitit 2020 ARH ka realizuar inspektim të makinistëve, në linjën hekurudhore Prishtinë-Pejë. Nga inspektimi i kryer në këtë linjë hekurudhore nga zyrtarët e ARH-së, ka rezultuar se trenat ditën e inspektimit kanë qenë duke u drejtuar nga makinistë të cilët janë të licencuar. Vlen të theksohet, se që nga licencimi i parë i makinistëve i bere nga ARH-ja në vitin 2015, nga të gjitha inspektimet në terren, përfshi edhe ato te realizuara gjate vitit 2020, ka rezultuar se trenat drejtohen vetëm nga makinist të licencuar. Megjithatë, ajo që mund të konsiderohet sfiduese në këtë aspekt është përgjithësisht mosha e shtyrë e makinistëve, shumica e të cilëve janë në të '50 apo '60. Në pozita tjera profesionale një moshë e tillë dhe një përvojë e gjatë, me shumë gjasë do ishte llogaritur si avantazh, mirëpo në pozitën e makinistit, ne si ARH vlerësojmë si sfiduese nga këndvështrimi i sigurisë hekurudhore. Andaj, është e rekomandueshme që kompanitë hekurudhore të freskojnë stafin e tyre të makinistëve me kuadro të reja.

6.4.2. Inspektimi i Infrastrukturës Hekurudhore

ARH në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me LH, neni 19 paragrafi 6, 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2020, ka kryer inspektimin e të gjitha linjave hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it, si dhe ka përgatitur raportin për të gjitha linjat e inspektuara. Gjatë procesit të inspektimit janë marrë parasysh të gjithë faktorët të cilët direkt apo indirekt kanë ndikim në sigurinë hekurudhore. Për secilën linjë të inspektuar është përgatitur një raport me të gjeturat kryesore gjatë inspektimit. Në raport janë përfshirë disa nga të gjeturat për te cilat ne kemi menduar se janë me të rëndësishme. Gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2020 kryesisht jemi fokusuar në inspektimin e vendkalimeve hekurudhore, pasi qe në vendkalime po ndodhin pothuajse të gjitha aksidentet dhe incidentet hekurudhore.

Linjat e inspektuara janë:

1. Prishtinë-Fushë Kosovë,
2. Klinë-Prizren,

3. Prishtinë-Podujevë,
4. Fushë Kosovë-Mitrovicë,
5. Fushë Kosovë-Pejë,
6. Fushë Kosovë-Hani i Elezit,
7. Bardh-Medvec,

Në raportet e përgatitura kemi paraqitur mangësitë të cilat ekzistojnë në secilën linjë veç e veç por kemi evidentuar edhe punët të cilat janë kryer nga ana e kompanisë Infracos. Gjatë inspektimit të linjave kemi konstatuar se është punuar në mirëmbajtjen e gjeometrisë së linjave, balastit, ndërrueseve dhe traversave. Shqetësuese për ne mbetet sinjalizimi dhe sigurimi i vendkalimeve. Në këtë pjesë ne mendojmë që duhet të punohet më shumë. Shumë vendkalime shtrihen në vendbanime ku frekuentimi nga ana e banorëve dhe automjeteve është mjaft i madh, në disa pjesë ka mungesë qoftë të sinjalizimit me shenja të komunikacionit rrugor, sigurim me semafor apo barriera (rampë). Ne mendojmë se këto vendkalime janë pikat me të rrezikshme të identifikuar nga ana e jonë.

6.4.3. Inspektimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore

Gjatë viti 2020, ARH ka kryer inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në menaxhim apo pronësi të Infracos, Trainkos, Railtrans dhe NewCo Ferronikeli Complex LLC, që janë të autorizuar për tu futur në shërbim nga ana e ARH-së.

Janë inspektuar këto parametra të sigurisë: Dimensionet e profilit të rrotave, trashësia e rrotave, papuçet e frenimit, sistemi i frenimit, hapja dhe mbyllja e dyerve, sistemi i ndriçimit, buria dhe radio lidhja, lidhëset e ajrit, çengeli etj.

Për të gjitha këto mjete lëvizëse hekurudhore është përgatitur nga një raport, ku kemi paraqitur të gjeturat gjatë procesit të inspektimit.

6.4.4. Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse NVR

Për të kontrolluar nëse mjetet lëvizëse hekurudhore me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore brenda territorit të Republikës së Kosovës janë të regjistruara, ashtu siç përcaktohen me rregulloren e regjistrimit 05/2012, ARH bazuar në punën dhe përgjegjësit e veta që ka, në baza vjetore realizon inspektimin e regjistrimit të mjeteve lëvizëse NVR.

Gjatë inspektimit NVR është realizuar edhe kontrollimi i shënimit të numrit identifikues unik dymbëdhjetë shifrore, i njohur si Numri Evropian i Mjetit Lëvizës, i cili ligjërisht duhet të jetë i shënuar në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të vendosura në shërbim që janë pjesë e regjistrit NVR. Përmes këtij numri identifikohet secili mjet lëvizës hekurudhor.

Përveç kësaj në mjetet lëvizëse duhet të bëhet e dukshme edhe kompania të cilës i përket. Kjo realizohet përmes shënimit të kodit VKM (Shënimit i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës), i cili është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtësës së mbajtësit/ndërmarrjes të mjetit lëvizës. Prandaj pjesë e procesit të inspektimit 2020 ka qene edhe VKM-ja, inspektim i realizuar njëkohësisht me inspektimin NVR.

Inspektimi NVR 2020 ka përfshirë mjetet lëvizëse të Trainkos-it, Infrakos-it, Railtrans-it dhe mjetet lëvizëse të New CoFerronikeli Complex LLC

Gjatë inspektimit ka rezultuar që të gjitha mjetet lëvizëse të Infrakos-it, Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it ishin të regjistruara dhe pjesë e NVR. Ndërmarrjet hekurudhore kishin të mbishkruar numrin identifikues evropian dhe kodin e VKM-së në të gjitha mjetet me të cilat administrojnë dhe operojnë.

Mbështetur nga të gjeturat e inspektimeve në teren janë përgatitur raportet me rekomandime për kompanitë e cekura më lartë. Raportet e finalizuar janë dërguar në të gjitha kompanitë më dt: 27/12/2020.

Ndërmarrja	VKM	Shteti	Statusi			Webfaqja
			Bllokuar	Në përdorim	Revokuar	
INFRAKOS	IHK	KS		Në përdorim		www.Infrakos.com
TRAINKOS	TRAINKOS	KS		Në përdorim		www.trainkos.com
RAILTRANS	RT	KS		Në përdorim		www.railtrans.biz
NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C	NCF	KS		Në përdorim		www.cunicoresources.com

Tabela 4: Kompanitë hekurudhore

6.5. Monitorimet

6.5.1. Monitorimi i licencave

Edhe gjatë vitit 2020 ne si ARH kemi monitoruar licencat e lëshuara ndër vite. Monitorimi i Licencës të Menaxherit të Infrastrukturës-Infracos dhe licencat për Ndërmarrjet Hekurudhore Trainkos dhe Railtrans, kryesisht ka qenë i përqendruar tek polica e sigurimit në raport me palët e treta, si mbulueshmërisë në rast të incidentit apo aksidentit hekurudhor brenda për brenda Kosovës. Në vazhdimësi ne si ARH kemi kërkuar që ky kusht të plotësohet pa ndërprerje, duke ju rikujtuar kohë pas kohe këtë detyrim ligjorë ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, përkundër faktit se një gjë e tillë është në përgjegjësinë direkt të tyre. Mirëpo, pavarësisht angazhimit tonë të vazhdueshëm në këtë pikë, përkundër se e gjithë përgjegjësia është tek kompanitë e licencuara që të sjellin në kohë sigurimin e kompanisë, në disa raste po haset në vonesa, në veçanti kompanitë publike. Sipas arsyetimit zyrtar të tyre, këto vonesa po ndodhin për shkak të procedurave të prokurimit, përmes të cilave duhet të shkoj ky proces dhe të cilat shpesh nuk mund të përfundohen sipas planifikimeve.

Ndërsa në kuadër të monitorimit të licencave të makinistëve të licencuar, hyjnë edhe raportet mjekësore periodike nga institucionet shëndetësore kompetente, të cilat i kërkon ARH-ja. Bazuar në legjislacionin në fuqi, makinistët mbi moshën 55 vjeçare, këto raporte mjekësore duhet t'i sjellin në baza të rregullta vjetore, kurse makinistët nën moshën e lartcekur, një herë në tre vite. Edhe gjatë vitit 2020 ARH ka pranuar raportet mjekësore nga ndërmarrjet hekurudhore për makinistët e tyre të licencuar.

6.5.2. Monitorimi i tregut hekurudhor

ARH, në kuadër të kompetencave ligjore, njërën nga përgjegjësitë kryesore e ka monitorimin e tregut hekurudhor në vend, monitorimin dhe kontrollimin e marrëveshjes mbi qasje në binar në mes të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Në kuadër të kësaj përgjegjësie, ARH ka monitoruar tregun hekurudhor në Republikën e Kosovës. Pas monitorimit është përgatitur raport i veçantë për monitorimin e tregut, ku në detaje ka paraqitur të dhënat e gjetura nga tereni dhe nga burime të ndryshme të informacionit prej entiteteve që merren me statistika dhe analiza të transportit në përgjithësi. Të gjeturat e Raportit të Monitorimit të Tregut për veç se i shërbejnë ARH-së dhe sektorit hekurudhor brenda për brenda Kosovës, të njëjtat raportohen në periudha vjetore edhe në Grupin e Rregullatorëve të Pavarur

Evropian – IRG Rail, ku ARH që nga viti 2013 është anëtare me të drejta të plota. Të dhënat e monitorimit të dërguara nga ARH, më pastaj përmbledhen dhe publikohen nga ky mekanizëm evropian, në një raport të veçantë ku përfshihen të dhënat e monitorimit të tregut hekurudhor për tërë Bashkimin Evropian dhe më gjerë.

Qëllimi i raportit të monitorimit është mbledhja e sa më shumë të dhënave për tregun hekurudhor, në mënyrë që këto të dhëna t'i vë në shërbim të funksionimit më të mirë të sektorit hekurudhor. Monitorimi i tregut është një instrument dhe mekanizëm i rëndësishëm i cili mund të kontribuoj në rritjen e cilësisë së shërbimeve në transportin hekurudhor, po ashtu raporti i monitorimit të tregut mund të shërbej si një dokument i rëndësishëm që paraqet zhvillimin e tregut hekurudhor në vend për të gjitha palët e interesit.

Dokumenti në të cilin përcaktohen treguesit e monitorimit të tregut, është i të njëjtit format me atë të IRG-Rail, për monitorimin e tregut hekurudhor, i cili është i njëjti për të gjithë rregullatorët të cilët janë të anëtarësuar.

6.6. Ekspozeu i Rrjetit 2020

ARH, gjatë vitit 2020, në kuadër të kompetencave ligjore ka kryer me sukses monitorimin e “Ekspozeut të Rrjetit 2020 dhe fillimin e procesit të konsultimeve për draft “Ekspozeun e Rrjetit 2020 ku ka bërë pranimin, shqyrtimin, analizimin, komentimin dhe ka dhënë rekomandimet për draft Ekspozeun e Rrjetit 2021, i cili draft është përgatitur nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore Infracos Sh.A. Lidhur me këtë, kemi mbikëqyrë procesin e konsultimeve mes palëve të interesit, siç janë: Infracos, Trainkos, Railtrans, MI, MZHE. Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infracos. ARH, ka pranuar ankesë nga ana e operatorëve hekurudhore lidhur me lartësinë e tarifave të propozuara nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore. Pas shqyrtimit të ankesave dhe fakteve të paraqitura se bashku me ankesat e lartcekura, ARH ka arritur në përfundim se çmimet e propozuara janë të larta për kushtet e tregut në Kosovë si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe si rezultat ka rekomanduar uljen e tarifave të propozuara.

Marrë për bazë, opinionin e ARH-së, Ministria e Infrastrukturës, ka aprovuar çmime më të ulëta nga ato të propozuara fillimisht në Ekspozeun e Rrjetit 2021.

6.7. Aplikime të reja

6.7.1. Licenca

Gjatë vitit 2020 ARH ka pranuar dhe shqyrtuar 16 aplikime për licencë makinisti. Dymbëdhjetë aplikacione janë pranuar nga Infracos dhe katër nga Trainkos. Të gjitha këto aplikacione së bashku me dokumentacionin përcjellës, brenda afateve dhe kritereve të papara ligjore, janë shqyrtuar nga ana e ARH-së. Shqyrtimi i këtyre aplikacioneve nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me LH si dhe Rregullores për Licencimin e Makinistëve. ARH gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë, në mënyrë që të marrë licencë. Këto kushte kanë qenë: Certifikata e Makinistit e lëshuar nga vetë ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konformë kërkesave të parapara në Ligj dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve si dhe kualifikimi shkollor, që nënkupton përfundimin e shkollës së mesme.

Të katër aplikacionet e Trainkos janë finalizuar me vendim pozitiv për dhënie të licencës së makinistit për katër makinistët e tyre, kurse ato të Infracos për shkak të mos kryerjes së pagesës së plotë, nuk kanë mundur të finalizohen ende.

Ndërsa sa i përket aplikimeve për licence për transport të udhëtareve apo mallrave nuk ka pasur ndonjë aplikacion gjatë vitit 2020, as nga kompanitë vendore apo ato ndërkombëtare. Bazuar në LH, tregu hekurudhor është i liberalizuar dhe se kompani të ndryshme të jashtme mund të aplikojnë për licencë të re apo njohje të saj. Vlen të theksohet se në vitet paraprake, ka pasur interesim nga kompani të huaja, të cilat janë interesuar për procedurat e njohjes së licencës Evropiane për transport hekurudhor të mallrave. Duke ju përgjigjur këtyre kërkesave për interesim, ne si ARH i kemi informuar rreth kritereve, procedurave si dhe afateve ligjore, që duhet të plotësohet nga një ndërmarrje e caktuar në mënyrë që të pajisen me licencë. Vlen të ceket se njohja e licencës Evropiane sipas ligjit është kompetencë e Ministres së Infrastrukturës. Gjatë vitit 2020, një interesim rreth hapjes së tregut hekurudhor dhe mundësisë që kompani të huaja të mund të hyjnë në tregun hekurudhor, ka pasur edhe nga Sekretariatit i Komunitetit të Transportit.

6.7.2. Njohja e Licencave për Makinist

Meqenëse LH e parasheh njohjen e licencave në sektorin hekurudhor mes Kosovës dhe vendeve të tjera, BE ka kërkuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi këtu edhe Kosovën që të hartohen kriteret dhe procedurat për njohjen reciprokë të licencave të makinistëve për sektorin hekurudhor. Kjo çështje është inkorporuar edhe në Traktatin që Themelon Komunitetin e Transportit i nënshkruar, në njërin anë nga Bashkimi Evropian, dhe në anën tjetër nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ne si ARH që disa vite radhazi e kemi ngritur këtë çështje zyrtarisht tek Ministria e Infrastrukturës, pasi që një përgjegjësi e tillë bie mbi këtë të fundit, në kuptim të nenit 10 paragrafi 4 të LH, meqenëse sipas ligjit për njohjen e licencave në sektorin e hekurudhave kompetente është Ministria. Gjatë vitit 2020, Ministria e Infrastrukturës ka përgatitur dhe dërguar tek palët e interesit Projekt Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Makinistëve të Trenit. Pavarësisht faktit se ne si ARH në vazhdimësi kishim shprehur gatishmërinë tonë që të përfshiheshim aktivisht në grupin punues për hartimin e këtij akti nënligjor, fatkeqësisht nuk ishim ftuar fare në hartimin e të njëjtit.

Pas pranimit të projekt Udhëzimit Administrativ në fjalë në fazën e konsultimit publik dhe pas analizimit të tij, ne si ARH kishim arritur në përfundim se ky projekt Udhëzim Administrativ është në kundërshtim me:

1. Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;
2. Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Infrastrukturës Nr. 17/2017 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencim të Operatorëve të Transportit Hekurudhor;
3. Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Infrastrukturës Nr. 18/2017 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencim e Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhor; si dhe
4. Kërkesat e Komisionit Evropian tash e sa vite.

ARH ndër vite ka plotësuar kornizën e akteve të nevojshme nënligjore në fushën e licencimit, në ato pjesë që LH i ka dhënë kompetenca të qarta ligjore organit licencuese në kuadër të ARH-së, siç parashihen në nenin 22(1) të ligjit, e që janë lëshimi i licencave për Menaxher të

Infrastrukturës Hekurudhore, Ndërmarrje Hekurudhore si dhe Makinistë. Qysh në vitin 2012 në bashkëpunim edhe me ekspert të Bashkimit Evropian përmes asistencës teknike të Zyrës së BE-së, ARH ka filluar rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës, ku pjesë e këtij rregullimi ishte edhe licencimi i pjesëmarrëseve hekurudhor. Si rezultat, në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës Menaxheri Infrastrukturës, Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Makinistët që operojnë në infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët janë licencuar.

Çështja që ka ngelur e pa rregulluar deri më tani dhe që është kërkesë e përsëritur nga Komisioni Evropian dhe Sekretariati Permanent i Komunitetit të Transportit, kërkesë kjo e përsëritur edhe në takimin e fundit mes Kosovës dhe Agjencisë Evropiane të Hekurudhave, DG MOVE, DG NEAR dhe Sekretariatit, i mbajtur me datë 06.11.2020, është njohja reciproke e licencave të makinistëve.

Në rast se njohja e licencave të huaja do të ishte kompetencë ligjore e ARH-së, kjo çështje do gjente zgjidhje dhe rregullim vite më parë, ngjashëm sikurse lëshimi i licencave. Mirëpo, ARH nuk ka mundur dhe as që mundur ta rregulloj këtë çështje pa amandamentim paraprak të Ligjit të Hekurudhave.

Bazuar në nenin 10(4) të Ligjit të Hekurudhave, është Ministria ajo e cila mund të pajtohet me vendet tjera për njohje e licencave të lëshuara në sektorin hekurudhor dhe jo ARH apo ndonjë institucion tjetër.

Në bazë të lartcekurave, sipas vlerësimeve të ARH-së, projekt Udhëzimi Administrativ në fjalë ishte në kundërshtim të plotë me nenin 10(4) të Ligjit të Hekurudhave.

Sipas nenit 1 të projekt Udhëzimit Administrativ, qëllimi i tij është përcaktimi i kompetencave, kriterëve dhe procedurave për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencave të makinistëve. Pra, qysh në nenin e parë ky projekt Udhëzimit Administrativ dështon të adresoj çështjen thelbësore të kërkuar që të rregullohet, njohjen reciproke të licencave të makinistëve. Në anën tjetër, kriteret dhe procedurat për lëshim, pezullim dhe revokim tashmë e disa vite janë rregulluar nga vetë Ligji i Hekurudhave në nenet 95-98 dhe Rregullorja Nr. 02/2013 për licencim të makinistëve. Në bazë të kësaj kornize ligjore ARH deri në këtë fazë ka lëshuar mbi 30 licenca për makinistë.

Neni 2(2.1) i projekt UA ishte në kundërshtim me nenin 96(6.3) të Ligjit të Hekurudhave sa i përket afateve ligjore brenda së cilëve vendoset për lëshim apo refuzim të kërkesës për licencë makinisti. Neni 2 (6.1) i projekt Udhëzimit Administrativ përveçse në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit të Hekurudhave ishte edhe në kundërshtim me nenin 2(1) dhe (2.2.1) të vetë këtij projekt Udhëzimit Administrativ, ngase ndërmarrjet hekurudhore nuk lëshojnë licenca për makinistë por organi licencues.

Nenet 4, 5 dhe 6 të projekt Udhëzimit Administrativ ishin në kundërshtim me nenin 10(4) të Ligjit të Hekurudhave. Bazuar në nenin 10(4) të Ligjit të Hekurudhave vetëm Ministria është organi kompetent që mund të vendos për njohje reciproke të licencave hekurudhore, ku bëjnë pjesë edhe ato të makinistëve Po ashtu, këto nene janë në kontradiktë edhe me njëra tjetrën, ngase nenet 4 dhe 6 e përcaktojnë organin kompetent për njohje të licencave, organin licencues që është ARH, kurse neni 5 përveç organit licencues, parasheh që edhe Ministria të jetë pajtuar me ministrinë e vendeve tjera për njohjen reciproke të licencave të makinistëve. .

Ky projekt Udhëzimit Administrativ përveçse në kundërshtim me Ligjin e Hekurudhave ishte në kundërshtim edhe me vetë Udhëzimet Administrative të Ministrisë të lëshuara kohë më parë, saktësisht me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencim të Operatorëve të Transportit Hekurudhor dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2017 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencim e Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhor. Në mënyrë që aktet nënligjore të mos jenë në kundërshtim me Ligjin e Hekurudhave, saktësisht nenin 10(4), vetë Ministria ka ndryshuar këto dy Udhëzime Administrative dhe organin kompetent për njohje të licencave në sektorin hekurudhor e ka përcaktuar në pajtim me dispozita ligjore Ministrinë, sepse paraprakisht në mënyrë të gabuar ishte përcaktuar ARH, ngjashëm sikurse me këtë projekt UA.

Ajo çka është kërkuar të rregullohet me një Udhëzimit Administrativ nga Komisioni Evropian dhe që është parapa edhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së tash e disa vite nga vetë Ministria e Infrastrukturës, ka qenë njohja reciproke e licencave të makinistëve mes Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera fqinje, dhe jo procedurat për lëshim të licencave të reja, ngase çështja e lëshimit të licencave është rregulluar tash e sa vite. Andaj në bazë të lartcekurave ky

draft Udhëzimit Administrativ nga ARH është konsideruar në kundërshtim me kërkesat e BE-së në këtë fushë.

Si rezultat i të lartcekurave, ne si ARH kemi kërkuar që i njëjti projekt Udhëzimit Administrativ të tërhiqen nga diskutimi publik si hap fillestar, dhe me pastaj të krijohet një grup punues nga ana e Ministrisë, ku një përfaqësues i ARH-së të jetë gjithsesi, dhe të fillohet me përgatitjen e një Udhëzimit Administrativ siç kërkohet për njohje të licencave e jo për lëshim të licencave dhe mbi të gjitha dhe para së gjithash, i njëjti të jetë në harmoni me Ligjin bazik. Përkundër faktit që ne si ARH kemi shprehur gatishmërinë e plotë për të dhënë kontributin tonë në këtë çështje në faza shumë më të hershme, si dhe komentimit të draftit fillestar, fatkeqësisht një gjë e tillë nuk qenka marr në konsideratë nga ana e Ministrisë, çka pa dyshim do ketë koston e vet dhe implikimet e saj në vonesa si dhe aspekte tjera.

6.7.3. Shqyrtimi i aplikacioneve të mjeteve lëvizëse të kompanisë italiane Generale Costruzione Ferroviare - GCF për autorizim dhe regjistrim

Kompania italiane GCF - Generale Costruzioni Ferroviarie S.p.A, zyrtarisht është e përzgjedhur për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore (Leshak-Hani i Elezit), që aktualisht po zhvillon punimet në këtë linjë me qëllim të përmirësimit të saj.

Përmes takimeve zyrtare është kërkuar nga kompania që të njoftohen rreth obligimeve ligjore që kanë në raport me ARH-në për makinerinë e tyre punuese që do të shërbejnë për punime gjatë rehabilitimit të kësaj linje.

Departamenti i sigurisë, duke qenë përgjegjës për autorizimet për futje në shërbim dhe në anën tjetër departamenti i interoperabilitetit përgjegjës për regjistrimin nacionalë të mjeteve lëvizëse hekurudhore NVR, kanë shqyrtuar/analizuar aplikacionet për mjetet e mirëmbajtjes së kompanisë italiane GCF.

